



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4, neni 15.5 nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 4 të Rregullës Zgjedhore nr.08/2013 Certifikimi i Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të Tyre, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 26.08.2021 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për certifikimin e subjektit politik Iniciativës Qytetare "Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës", (LPRK), dhe listës prej 9 (nëntë) kandidatëve për Kuvend Komunal në Komunën e Zveçanit, për pjesëmarrje në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.
- II. Ky subjekt politik certifikohet për të marrë pjesë në zgjedhjet për Kuvend Komunal në Komunën e Zveçanit.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj Iniciativën Qytetare **Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës**, për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim në të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje, jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për radhitjen në fletëvotim.
- V. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, të gjithë personat që kanë interes ligjor kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës – PZAP.